



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 12.03.2012, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 24.02.2012;**
- 3. Mbikëqyrja e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Kosovë;**
- 4. Të ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura, më 24.02.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 24.02.2012 pa vërejtje.

3. Mbikëqyrja e buxhetit të institucioneve të sigurisë në Kosovë

Kryetari i Komisionit- Për këtë çështje kemi një propozim nga OSBE-ja që të kemi një angazhim për menaxhimin e buxhetit për institucionet që i monitorojmë, duke qenë se ky projekt mbështetet nga kjo organizatë fjalën ia kaloj përfaqësueses së kësaj organizate.

Dhurata Kryeziu – Edhe për vitin 2012 OSBE-ja do ta përkrah Komisionin me fokus të veçantë në rolin mbikëqyrës të Komisionit, përveç mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit që është bërë në vitin e kaluar(2011), për këtë viti Komisioni do të përkrahët me dy ekspert, njëri ndërkombëtar dhe tjetri vendor për mbikëqyrjen e buxhetit të ministrive që mbikëqyren nga Komisioni dhe në mbikëqyrje të performancës.

Eksperti ndërkombëtarë do të jetë një ish-deputet ndërsa eksperti vendor do ta përkrah ekspertin ndërkombëtar dhe të jetë i njoftuar me fushën e buxhetit dhe financave.

Moduli i trajnimit do të jetë trajnim për deputet për ciklin buxhetor, njoftim rreth raporteve të audituara të ciklat i kërkon zyra e auditorit gjeneral tek Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike si dhe mbikëqyrja e raporteve të performancës që dërgohen nga ministrinë.

Ardhja e ekspertit ndërkombëtar varet nga koha e lirë e Komisionit, dhe kohës kur vijnë raportet e audituara dhe të performancës nga Ministrinë. Periudha maj, qershor dhe korrik do të ishte e përshtatshme.

Kryetari i Komisionit- Sa i përket menaxhimit të buxhetit ka pasur vërejtje jo vetëm për ministrinë që mbikëqyren nga Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, ofrimi i kësaj ndihme do të na ndihmonte të ushtronim kontroll demokratik në fushën e financave. Data e saktë do të përcaktohet në takimet e radhës, por muaji maj dhe qershor do të jenë të përshtatshëm.

Fatmir Xhelili- Mbështes idenë dhe mendoj që do të bëjmë një punë të mirë që do të ketë rezultate në të ardhmen. Propozoj që të formojmë një grup punues në kuadër të Komisionit, për hartimin e një plani duke filluar nga kërkesa që Ministrinë që mbikëqyren

nga Komisioni të na i dërgojnë të dhënat për evidentimin e pronës së ministrive dhe segmenteve që lidhën këto ministri, si dhe evidentimin e procesit të inventarizimit.

Nëse një proces i tillë ka përfunduar të analizohen dhe vlerësohen, nëse financat janë shpenzuar në mënyrë kuantitative por, edhe analizimi i kualiteteve të investimeve, mjeteve, pranimeve, edukimeve për të cilat janë ndarë mjete, si dhe vlerësimi për përcaktimin e politikave, prioriteteve nëse është bërë më kohë dhe drejtë.

Planifikimi i buxhetit zakonisht bëhet për një periudhë të shkurtër duke shmangur planifikimet për identifikimin e nevojave të mekanizmave të shtetit për punën që duhet të kryejnë duke e shmangur esencën e problemeve se ku po investohen mjetet e ndara.

Për këtë arsye propozoj formimin e grupit punues që do të planifikonte fazat, duke u dhënë mundësinë Komisioneve të tjera të ushtrojnë funksionin mbikëqyrës dhe pas një periudhe katërvjeçare do të identifikoheshin rezultatet e produktit. Për këtë projekt mund të kërkojmë kapacitete shtesë për të zhvilluar këtë projekt.

Kryetari i Komisionit- Pajtohem me propozimin e z. Fatmir Xhelili për krijimin e një grupi punues për këtë çështje, në mënyrë që të krijohet skema dhe një përkujdesje për menaxhimin e buxhetit ndaj ministrive. Ministrive mund tu japim edhe propozime si dhe vërejtje nëse mund të ketë pasur devijime në shpenzimin e buxhetit.

Propozoj që udhëheqës i grupit punues të jetë z. Fatmir Xhelili, anëtarët z. Anton Quni, z. Emin Gërbeshi, z. Rexhep Selimi dhe znj. Vjollca Krasniqi. Skema e organizimit të punës së mëtutjeshme do të ofrohet në këtë drejtim.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë do të ju njoftoj për takimin e Komisionit me Ministrin e Punëve të Brendshme të Shqipërisë z. Bujar Nishani.

Takimi konsistonte në shkëmbimin e përvojave dhe lehtësisë së qarkullimit të qytetarëve të dy vendeve, bashkëpunimit mes dy Komisioneve për Siguri, të Kosovës dhe të Shqipërisë si dhe bashkëpunimi mes Ministrive të Punëve të Brendshme të dy vendeve, duke kërkuar shkëmbim të përvojave më të mira.

Për dy ditë to të jem në një vizitë në Strasburg, ku do të jenë kryetarët e komisioneve parlamentare, ndërsa për vizitën në Gjermani duhet të përgatitemi referuar në agjendën e përgatitur nga Ambasada gjermane dhe GIZ-i.

Nga Inspektorati Policor kemi marrë Raportin shtesë i kërkuar nga Komisioni, dhe në mbledhjen e radhës do të shqyrtohet.

Goran Marinković- Kërkoj falje për mos praninë në takimin me Ministrin e Punëve të Brendshme të Shqipërisë, por për arsye se kam ardhur një orë më herët pa filluar takimi dhe më është dashur të pres, nuk kam mundur të jem i pranishëm.

Një çështje tjetër është libri i cili më është dërguar, që ka të bëjë për sektorin e sigurosh, nuk është në gjuhën serbe dhe do të doja që ta kisha në këtë gjuhë.

Kryetari i Komisionit- Libri është përgatitur nga një organizatë jo qeveritare dhe nuk e kanë përgatitur versionin në serbisht. Do të ishte mirë që të ishte edhe në gjuhën serbe, por do të kërkojmë që të ofrohet edhe versioni në gjuhën serbe.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi